



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM  
PËR MBLEDHJE PLENARE  
06 Mars 2023

**Informacion mbi mbledhjen:**

<b>Dita/Data:</b>	E hënë, 06.03.2023
<b>Ora:</b>	10.00
<b>Kohëzgjatja:</b>	~ 120 min
<b>Thirrur nga:</b>	Kryetari i Këshillit
<b>Pjesëmarrësit:</b>	Anëtarët
<b>Kuorumi i nevojshëm:</b>	7 anëtarë

*Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Programi OPDAT. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.*

**Rendi i ditës:**

1. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 23.02.2023.
2. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit “Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Rifat Kojku, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.”
3. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit “Për zgjatjen e komandimit, në ministrinë e drejtësisë, të prokurorit Bledar Mustafaraj.”
4. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të zotit Aurel Zarka”.
5. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të zotit Artur Cara”.
6. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të zotit Elio Mazreku”.
7. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të zotit Sokol Nishani”.
8. Diskutimi/ miratimi i relacionit “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Genci Mane, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

9. Hedhja e shortit për caktimin e relatorit *për vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier*”.
10. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.317, datë 02.12.2022 *“Për caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve” të ndryshuar.*
11. Paraqitje e *“Raportit vjetor 2022 të Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve”*
12. Paraqitje e *“Raportit vjetor 2022 të Komisionit Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”.*
13. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit *“Për ristrukturimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.*
14. Diskutimi/miratimi i projekt-vendimit mbi ankesën e prokurorit Ilir Hoxha, ndaj *udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.*
15. Diskutimi/miratimi i relacionit për një shtesë në Rregulloren *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me Vendimin Nr.171, dt. 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.*
16. Diskutim/miratimi i relacionit *“Për një ndryshim në Vendimin Nr.157, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë“ për praktiken profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, të ndryshuar”.*
17. Diskutim/miratimi i relacionit *“Për ndërprerjen e komandimit të prokurorit Ols Dado në Prokurorinë e Përgjithshme dhe dhënien e opinionit për transferimin e tij në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.*

**Të tjera (pyetje/diskutime).**

Urdhërohet sektori i dokumentimit të seancave të bëj publikimin e kësaj axhende në faqen Web të Këshillit.

Njoftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të siguruar pjesëmarrjen.

**Kryetar  
Alfred Balla**